Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

339, 346/19
05.08.2019

PSH.nr. 339/19
346/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina- Kryetar, z.Nuhi Paçarizi–Referues, z.Goran Milenković –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik"Nika Pro ing & Bejta Comerc" sh. a si dhe OE i dytë ankues "El- Bau" shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës tëaktivitetit tëprokurimit me titullprokurimit:"Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug", me numër të prokurimit: 210/19/1666/5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), më datën:25. 07. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Nika Pro ing & Bejta Comerc" sh. a si dhe OE "El- Bau" shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: "Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug", me numër të prokurimit: 210/19/1666/5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit: "Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug", me numër të prokurimit: 210/19/1666/5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues aprovohen pjesërisht si te bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë-01.04.2019

Lloji i procedurës së aplikuar-Procedurë e hapur

Vlera e parashikuar e kontratës- 700,000.00

Kriteri për dhënie të kontratës- tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Data e hapjes së ofertave-10.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave- 05.06.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar- 06.06.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës- 06.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim "Nika pro-ing& Bejta Commerce"-10.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim "EL-BAU SH.P.K"-10.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "Nika pro-ing& Bejta Commerce; 14.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "EL- BAU"SH.P.K; 17.06.2019

Me datën: 24.06.2019, OE "Nika Pro-ing & Bejta Comerce" sh.a - Ferizaj, dhe me datën 26.06.2019, OE "EL-Bau" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE "Arbor Group sh,p,k & Teuta-M SH.P.K - Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug me nr. të prokurimit: 210/19/1666/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.07.2019,ka autorizuar

ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore i cili në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë ankimor është se OE "Nika Pro-ing & Bejt Commerc" është njoftuar me letër standarde për tenderues të pasuksesshëm në projektin e lartpërmendur ku jemi njoftuar për pikat qe nuk i kemi plotësuar kërkesë sipas FTD-së:

Ne pretendimin1. E kundërshtojmë për arsye që në FTD ceket shumë qartë se OE të siguroj AK-në për materialet e përdorura të jenë sipas kërkesës, mirëpo nuk është kërkesë e AK-së që të sjellë në këtë fazë certifikatën EN-13748-2 & ISO 9001:2015,

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesat e AK –së nuk ka qenë të qarta ku kërkesat e vendosura ne DT tek kapaciteti teknik dhe profesional jan të njëjta me dëshmitë e kërkuara dokumentare. Kërkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë janë:

Kapaciteti teknik dhe profesional:Dëshmia e kërkuar dokumentare

Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne përputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për sistem hermetik te makinerisë prodhuese, për artikullin e kërkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njështresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt). Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontraktues se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njeshtresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).

Sa i përket kësaj pike OE ankues ka pasur te drejë të kërkoj sqarim nga AK-ës duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt.18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kësaj kërkese eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e juaj është e bashkangjitur një deklaratë ku keni cekur se do të ofroni pllaka tarraco me EC dhe të certifikuara me ISO standarde të kërkuar. Andaj duke pasur parasysh kërkesat e paqarta të AK-së për dëshmitë dokumentare në këtë pikë dhe sqarimet që u dhanë me lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se jemi eliminuar për arsye ku ceket se na mungojnë dy kamioneta-min 2 copa & pompa e ujit 2 copa. Ne listën e makinerisë te "Bejta Commerc" janë të dëshmuara edhe nga ana e noterit EN minutes se këto makineri edhe tjerat e më shumë jan të dëshmuara se jan në pronësi te OE "Bejta Commerc "nga Gjilani

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK –së dhe dokumentacionit të bashkangjitur në ofertë konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë:

Lista e pajisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes. Listës së pajisjeve t'i bashkëngjiten këto dëshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes. Makineria e cila merret në huazim, ti bashkëngjitet edhe marrëveshjen e bashkëpunimit-huazimit-qiramarrjes (të noterizuar).

Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se ne dokumentacionin e bashkangjitur ne ofertën e Grupi i OE "Pro-ing dhe Bejta Comerce" ku lista e pajisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes është e bashkangjitur në ofertë, në këtë listë figurojnë 2 kamion cisterne ku kanë të bashkangjitur librezat mbi pronësinë e tyre ku plotëson kërkesën e AK-së.

Ndërsa sa i përket kamionetave në ankesën e bere nuk është sqaruar se çfarë gabimi teknik është bere tek shënimi i kamionëve . Prandaj nga kjo qe u tha me lartë eksperti shqyrtues konstaton se ky kundërshtim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Ne pretendimin 3. E kundërshtojmë për arsye se në listën e stafit të OE Nika Pro-ing është ne liste inxhinieri z. Bashkim Hasani i cili plotëson kërkesën e AK –së ku të njëjtin e kemi punëtor të rregullt në kompani // këtë pretendim AK-ja gjatë kërkesës për ri-shqyrtim e ka pranuar se e kan gabuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se inxhinieri Bashkim Hasani plotëson kërkesën e AK-së dhe kjo pik është vërtetuar edhe nga AK-ja në përgjigjeje e kërkesës për ri-shqyrtim .

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK-ja në kundërshtim më LPP-në ka vepruar ka konstatuar se na mungojnë licenca nga ministria e bujqësisë për prodhim , tregtim dhe import të bimëve dekorative , pasi qe marrëveshja e bashkëpunimit me z Naim Maliqin nuk vlen për plotësimin e kërkesës së AK-së .Ne e kemi plotësuar këtë kriter pasi që në marrëveshjen tonë të noterizuar e kemi cekur se furnizimet i bën kompania e licencuare.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkesë e AK-së ka qene:

Dëshmi Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim, tregtim dhe import te bimëve dekorative (kopje e noterizuar) .

Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo marrëveshje nuk mund te konsiderohet e vlefshme pasi qe nuk ka qen kërkesë e AK-së qe të plotësohet me ndonjë marrëveshje bashkëpunimi. Prandaj nga kjo qe u tha me lart del qe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi tjetër i OE ankues është se për Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim AK-ja këtë kriter e ka vendosur në kundërshtim më LPP-në pasi qe në paramasën e këtij projekti nuk është për të mbjellurë asnjë bimë, apo drunj dekorativ.

Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se OE duke u bazuar ne nenin 108/A paragrafi 1 dhe 3.1 të LPP-së OE ankues ka pasur te drejt të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-së ne këto raste deri ne afatin kohor te përcaktuar me neni 108/A ku thotë:

1. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   1.3. Në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasi nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme 750.000,00 ku në raste konzerciumi lideri duhet të ketë 60% të vlerës së kontratës.

Ekspert shqyrtues sqaron se kërkesë e AK –së në këtë pikë në dosjen e tenderit ka qenë:

Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin për kontrate ka kryer me sukses pune të natyrës së ngjashme. Vlera e punëve te kryera duhet te jete minimumi 750,000.00 euro.

Prandaj duke u bazuar ne kërkesat e AK-së eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron pasi qe tek ky kriter nuk është kërkuar që në raste konzerciumi lideri duhet të këtë 60% të vlerës së kërkuar dhe si i tillë ky pretendim është i pa bazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES "EL-Bau "sh.p.k - Gjilan.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë i OE ankues është se në kërkesën e vendosur nenin 9.2 nuk është kërkuar asnjë dëshmi dokumentare duke përfshirë por pa u kufizuar ne Marrëveshje me prodhuesin, Licencë për prodhimet e betonit-pllakave tarraco me CE, por që shprehimisht është përshkruar kërkesa si në pikën 9.1

Poashtu Kërkesa e AK-së është qe materiali/produkti në fjalë duhet të posedojë teste të certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (sistemi për menaxhimin e cilësisë". OE ankues e plotëson në tërësi kërkesën në fjalë ngase i ka në posedim certifikatat specifike të kërkuara nga AK siç e vërtetojnë dëshmitë që ju bashkëngjisim.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesat e AK –së nuk ka qenë të qarta ku kërkesat e vendosura ne DT tek kapaciteti teknik dhe profesional jan të njëjta me deshmit e kërkuara dokumentare. Kërkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrat janë:

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontraktues se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet te jete i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për sistem hermetik te makinerisë prodhuese, për artikullin e kërkuara sipas pozicioni. Pllaka terastone njështresore nga graniti dhe mermeri me granil	Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontraktues se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojnë ateste te certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet te jete i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për sistem hermetik te makinerisë prodhuese, për artikullin e kërkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njështresore nga graniti dhe mermeri me granil

natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).	natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).

Sa i përket kësaj pike OE ankues ka pasur te drejtë të kërkoj sqarim nga AK-së duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt.18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kësaj kërkese eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e juaj është e bashkangjitur një deklaratë ku keni cekur se do të ofroni ateste sipas kërkesës se AK-së për pozicionet të cilat janë ne paramasë. Andaj duke pasur parasysh kërkesat e paqarta të AK-së për dëshmitë dokumentare në këtë pikë dhe sqarimet që u dhanë me lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK-së konstaton se *Tek kapaciteti teknik dhe profesional tek pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar "NUK QËNDRON"* nuk është dhënë një arsyetim konkret se për cilën pajisje bëhet fjalë që mungojnë librezat apo DUD-at.

Eksperti shqyrtues konstaton ne ofertën e OE ankues është e bashkangjitur lista e makinerisë dhe AK-ja është dashur të cek qartë se për cilat makineri mungojnë dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit. Prandaj nga sqarimet më lart del se ky pretendim ankimor qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK ka kufizuar OE kur ata e konsiderojnë të nevojshme që me OE të caktuar që posedojnë kapacitetin e nevojshëm dhe janë të licencuar siç është rasti konkret për tenderin në fjalë për një pozicion të caktuar për plotësimin e kërkesës lidhur me licencën në fjalë,të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, të krijojnë konzerciumi bashkëpunimi,të nënkontraktojnë punën deri në 40% të vlerës së kontratës duke mos lejuar marrëveshje bashkëpunimi .

Ne tenderin e cekur objekt i kontratës është rregullimi dhe pastrimi i lumit Hogosht deri te ura në Gjilan që përbën 99.5% të kontratës, nuk ka të bëjë fare me bimë dekorative në krejt lëndën është vetëm një pozicion 3.11 andaj kufizimi i konkurrencës sipas logjikës së AK-së përmes licencës të cekur nga Ministria e Bujqësisë vetëm nga OE ofertues pa e lënë mundësinë e marrëveshjes do t'i mundësonte vetëm OE-ve të caktuar që të shpërblehen me kontratë.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi duke u bazuar ne nenin 108/A të LPP-së konstaton se paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thotë:

2. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

1.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-ës ne lidhej me dokumentet e tenderit brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave. Dhe si i tillë ky pretendim në këtë fazë të këtij aktivitetit të prokurimit nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën nga neni 9.2 të FTD-së lidhur më kapacitetin teknik mjetet e punës për shkak se dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) në tërësi janë të palexueshme, nuk iu dihet përmbajtja dhe si të tilla nuk kanë ndonjë fuqi provuese /dëshmuese , janë ekuivalente me një dokument si letër e bardhë . Dhe për me tepër të njëjtat pajisje qe i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce".

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se ne ofertën e OE "Arbor sh.p.k për listën e pajisjeve dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) disa nga to janë te palexueshme poshtu disa makineri të cilat i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta comerce" janë të njëjta që do ti përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce".Prandaj nga sqarimet që u dhanë me lartë del qe ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmime ab-normalisht të ulët ne pozicionet 3.1, 4.6 dhe 4.7.

Eksperti shqyrtues ne vazhdim ka llogaritur në mënyrë te detajuar çmimin për pozicionet në fjalë.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
1	EL-Bau	POZICIONI 3.1	98,385.00	
2	"ARBORN GROUP"	POZICIONI 3.1	81,519.00	
3	VARNA sh.p.k	POZICIONI 3.1	91,357.50	
4	NIKA PRO-ING sh.p.	POZICIONI 3.1	70,275.00	
5	EUROFAMIS Sh.a	POZICIONI 3.1	98,385.00	
6	INFRA PLUS sh.p.k	POZICIONI 3.1	63,242.50	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	503,164.00	
9		mesatarja (C8/6)	83,860.66	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	64,508.2	ne ketë rast oferta e OE "ARBOR SH.P.K. nuk përmbush kushtin e dyte prandaj NUK vazhdohet me kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta.
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e OE "Arbor grup" sh.p.k nuk plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me pak se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
Konkludim	oferte e OE "Arbor Group" nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet sipas paragrafit 3.1	

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne rregullat për tenderin ab-normalisht të ulët dhe në llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 3.1 nuk mund te konsiderohet si pozicion ab-normalisht e ulet. Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Llogaritja për pozicionin 4.6

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
1	"EL-Bau" sh.p.k	POZICIONI 4.6	10,080.00	
2	"ARBOR GROUP"	POZICIONI 4.6	10,560.00	
3	VARNA sh,p,k	POZICIONI 4.6	28,800.00	
4	"NIKA PRO-ING"sh.p.k	POZICIONI 4.6	12,480.00	
5	"EUROFAMIS" Sh.a	POZICIONI 4.6	9,600.00	
6	"INFRA PLUS" SH.P.K	POZICIONI 4.6	14,400.00	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	85,920.00	
9		mesatarja (C8/6)	14,320.00	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	11,015.38	ne ketë rast oferta e OE "Arbor Group" sh.p.k përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi

1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e OE"Arbor Group "SH.P.K nuk plotëson kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe nuk është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 nuk plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet	

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne rregullat për tenderin ab-normal të ulët dhe në llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 6.4 nuk mund te konsiderohet si oferte ab-normalisht e ulet pasi qe nuk ka përmbushur tri kushtet. Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Llogaritja e pozicionit 4.7

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
1	EL-Bau	POZICIONI 4.7	16,800.00	
2	ARBOR GROUP	POZICIONI 4.7	6400.00	
3	VARNA	POZICIONI 4.7	32,000.00	
4	NIKA PRO-ING	POZICIONI 4.7	19,200.00	
5	EUROFAMIS	POZICIONI 4.7	8,000.00	
6	INFRA PLUS	POZICIONI 4.7	24,000.00	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	106,400.00	
9		mesatarja (C8/6)	17,733.33	

10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	13,641.02	ne ketë rast oferta e OE Arbor sh.p.k përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	7,272.72	ne ketë rast oferta OE Arbor sh.p.k përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet	

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 4.7 konsiderohet si pozicion ab-normal e ulët. Po ashtu eksperti shqyrtues sqaron se AK-ës duke u bazuar ne rregulloren për çmimin ab-normalisht të ulet është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime në lidhje me këtë pozicion .Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi tjetër Ankimor është lidhur me dyshimin për vendosjen e kritereve favorizuese për OE fitues dhe diskriminuese për OE tjerë dhe në kundërshtim me objektin e lëndës.

Konsiderojmë se kriteret e vendosura lidhur me Licencat nga ministria e Bujqësisë për Prodhim,tregtim dhe import te bimëve dekorative, janë kritere që i janë përgatitur dhe përshtatur OE "Arbor Group" dhe për më tepër dyshojmë se këto kritere janë sjellë apo rekomanduar në AK nga vet OE në fjalë me qëllim

të eliminimit të konkurrencës kundrejt OE të tjerë. Dihet se ky OE fitues posedon këtë licencë, ndërsa për projektin dhe të vetmin pozicion 3.11 Furnizimi, transporti dhe mbjellja e shtresës vegjetative me t=20cm, sipas detalit të projektit,nuk është e domosdoshme posedimi i licencës, për këtë i bie se është përgatitur dhe

Operatori ekonomik OE ankuesEl Baupërmes parashtresës me shkrim të datës: 22 korrik 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

përshtatur me kritere qysh nga fillimi i hartimit dhe shpalljes së këtij aktiviteti të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi duke u bazuar ne nenin 108/A të LPP-së konstaton se paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thot:

3. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

1.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim pran AK-ës ne lidhej me dokumentet e tenderit brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave. Dhe si i tillë ky pretendim në këtë fazë të këtij aktivitetit të prokurimit nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.7

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqyrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar nenin 108/A te LPP-në paragrafi 12, ku thot:

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

Poashtu duke u bazuar në sqarimet më lart eksperti shqyrtues sqaron se AK-ës është dashur te jap përgjigjej në te gjitha pretendimet ankimore te OE ankues dhe ti arsyetoj ato. Prandaj nga kjo qe u tha me

lar del se ky pretendim ankimor është i bazuar

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 16 korrik 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi së OE i parë ankues deklaroj:"Pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertes shqyrtuese. Pas njoftimit te eliminimit te nga ky AP te pa kënaqur kemi ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar ankesën tone dhe me date 24.06.2019 kemi ushtruar ankese ne OSHP qëndrojmë ne tërësi te pretendimeve ankimore ne ankese. Pretendimi i pare, Autoriteti Kontraktues e ka ceke qe nuk e ka përmbushë certifikatën EN -13748-2 dhe ISO 2001/2015 ne konsiderojmë qe këtë kërkesë e kemi plotësuar përmes deklaratës e cila është e nënshkruar dhe e vulosur nga personat përgjegjës ku kemi cekur se do te ofrojmë produkte sipas kërkese se Autoriteti Kontraktues. Pasi qe ne FDT kërkesat e Autoriteti Kontraktues nuk kanë qenë recidive këto standarde duhet te sillen ne dosje, konsiderojmë qe eliminimi i jone është i padrejte. Ne pretendimin dyte edhe këtë e kundërshtojmë me arsye se na mungojnë 2 pompa te ujit dhe 2 Kamionët, ne listën e makinerisë se OE "Bejta Comerce" janë te dëshmuar me procedurat e noterit EN Minutes se këto makineri janë ne dosje dhe janë ne pronësi te OE"Bejta Comerce" ne lista shkruan Cisterne (e nyejt me pompat e ujit) si dëshmi kemi ofruar librezat dhe fotografit qe dëshmojë se OE i posedon këto 2 Cisterna, poashtu ne listën e makinerisë janë edhe 2 kamionët me libreza qe janë te dëshmuar me procesin En minutes. Pretendimi i 3 e kundërshtojmë fuqishëm sepse lista e stafit e OE "Nika Proing" është z. Bashkim Hasani Ing i Dip i Ndërtimtarisë i cili posedon përvojë me shume se 3 vite ku te njëjtin e kemi punëtor te rregullt ne kompani, vlen te cekte se këtë konstatim gjatë kërkesës për rishikim Autoriteti Kontraktues e ka pranuar se ka gabuar, ne piken shtese ku Autoriteti Kontraktues ka kërkuar licencën nga Ministria e Bujqësisë për bimët dekorative drunjte dekorativ. Konsorciumi ynë ka

ofruar një marrëveshje bashkëpunimi me z, Naim Maliqi për plotësimin e kësaj kërkesë te Autoriteti Kontraktues. Ne kërkesë e FDT-së nuk ceket se OE Lider duhet ti posedoj këto licenca, ne paramasë dhe parallogarit nuk asnjë drunj apo bime dekorative. Sa i përket OE te rekomanduar për kontrate gjatë shikimit te dokumentacionit konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje se pari duke propozuar një OE me çmim me te larte se Oferta jone për te cilën konsiderojmë qe është me e ultë ne këtë AP dhe duke i ditur qe kërkesa e FDT-së ka qen recidive qe ne rast konsorciumi Lideri duhet te plotësoj 60% te vlerës se kontratës atëherë del se Lideri nuk e plotëson 60% e kërkesës se FDT-së, kjo vlere ka qen ne kërkesë te jete 900.000 euro. Gjithashtu lideri ka dështuar te ofroj dëshmi nga një Banke ne vlere prej 540.000 euro".

Në vazhdim kryetari i panelit i dha fjalën përfaqësuesit të OE-së së dytë ankues z. Pireva i cili deklaroj: "I nderuar panel shqyrtues, Konsiderojmë se në këtë aktivitet të prokurimit, AK-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e nxjerrjes së vendimit për dhënien e kontratës OE «Arbor Group» sh.p.k. & K.N.T.SH «Teuta-M» sh.p.k dhe eliminimin e ofertës të OE ankues nuk ka vepruar sipas parimeve bazike dhe kryesore të vlerësimit, për shkak se me rastin e vlerësimit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës të përcaktuara me dispozitat materiale nga neni 59.4 dhe nenin 60 par. 1.1 lidhur me nenin 1 dhe 7 të LPP-së. Për më tepër siç vendimi nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e ligjit dhe nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike që për pasojë ne si OE ankues jemi diskriminuar duke na u mohuar e drejta për marrjen e kontratës pasi që i plotësojmë në tërësi kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit si dhe kriterin për dhënien e kontratës e tenderuesit të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Siç i kemi potencuar pretendimet në ankesë, shkeljet konsistojnë në rrethanat e cekura si në vijim:

Në pikëpamje të arsyetimit ligjor dhe gjendjes faktike arsyetimet që i AK i ka dhënë për eliminimin e ofertës tonë NUK QËNDROJNË të bazuara..
Në kërkesën e vendosur në nenin 9.2 të FTD-së lidhur me kërkesën 9.1 të FTD-së sa i përket produktit të pllakave terraso që thuhet të posedojnë shenjën CE dhe EN 13748-2, i certifikuar sipas ISO 9001 2015, NUK ËSHTË KËRKUAR asnjë dëshmi dokumentare duke përfshirë por pa u kufizuar në Marrëveshje me prodhuesin, Licencë për prodhimet e betonit – pllakave terraco me CE, por që shprehimisht është përshkruar kërkesa si në pikën 9.1 siç po e parafrazoj: "*OE të siguroj AK se materialet e pozicionit ku përdoren pllakat teraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti të posedoj shenjën CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 ashtu që duhet të posedojnë*

teste të çertifikuara me shenjën CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi për menagjimin e cilësisë"

Pra në arsyetimin e dhënë në pikën 1 të letrës standarde, oferta jonë është diskualifikuar mbi bazën e një kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në dosjen e tenderit dhe që përbën shkelje ligjore në kuptim të nenit 56 par. 3 të LPP-së.

Ky pretendim është vërtetuar si i bazuar edhe nga eksperti shqyrtues në përgjigjen Nr. 1 i cili për më tepër ka nxjerrur konstatimin se kërkesat e e AK të vendosura në DT lidhur me këtë kriter NUK KANË QENË TË QARTA.

Po ashtu siç pretendimi jonë është vërtetuar edhe nga eksperti shqyrtues në Përgjigjen Nr.2 të ekspertizës, nuk qëndron i bazuar as arsyetimi për eliminim që është dhënë në pikën 2 të letrës standarde gjoja se në dosjen e dorëzuar nga ankuesi *Tek kapaciteti teknik dhe profesional, OE tek pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar.* AK nuk e ka dhënë asnjë arsyetim konkret për ta specifikuar me përshkrim të saktë se cilat libreza apo duda mungojnë dhe cilës pajisje i referohet AK.

Sa i përket arsyetimit të tretë ku thuhet *Si dhe çmimit më të lartë në krahasim me OE fitues*, ky është një fakt konkret që dëshmon që AK me apo pa qëllim nuk është në gjendje të dallojë kriteret e përzgjedhjes me kriterin për dhënien e kontratës.

Sa i përket pretendimit ankimor Nr. 3 lidhur me ngritjen e dyshimit për vendosje të kritereve favorizuese dhe në kundërshtim me objektin dhe lëndën e kontratës lidhur me Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim, tregtim dhe import te bimëve dekorative, konsiderojmë se ky kriter nuk është drejtpërdrejtë relevant dhe proporcional në raport me lëndën e kontratës përkatëse dhe është vendosur në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së

Lënda e kësaj kontrate është "rregullimi, pastrimi i lumit....." pra objekti i lëndës nuk ka fare të bëjë me bimë dekorative. Në krejt lëndën e këtij aktiviteti është vetëm një pozicion dhe atë pozicioni 3.11 që ka të bëjë lidhur me këtë produkt që në vlerë monetare përbën afërsisht 3,000.00€ e ndërsa krejt vlera e parashikuar e projektit është 700,000.00€.

Në mbështetje të këtyre fakteve konsiderojmë se ky kriter është diskriminues dhe iu është përshtatur kushteve dhe rrethanave të kompanisë fituese "Arbnor Group" dhe konsiderojmë se është vendosur me qëllim të ndikojë dhe kufizojë konkurrencën dhe favorizojë OE fitues në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 130 par. 1.3 të LPP-së

Në bazë të përgjigjes së ekspertit shqyrtues vërehet se ky pretendim nuk është shqyrtuar fare përkundrejt se e ka pasur për detyrë ligjore ta shqyrtojë së bashku me pretendimet tjera. Andaj kërkojë që të mirret në konsideratë dhe shqyrtohet sot në këtë seancë nga ana e panelit shqyrtues pasi ka të bëjë me shkeljen e

parimit themelor (*barazia në trajtim/jo-diskriminimi)* të rregullave të prokurimit publik. OE fitues ARBNOR GROUP ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm

Provat me të cilat vërtetojnë se OE i rekomanduar për kontratë ARBNOR GROUP, nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të dosjes së tenderit të vendosura në nenin 9.1&9.2 të FTD lidhur me kapacitetin teknik –mjetet e punës, dhe dorëzimin e tenderit jo-normalisht të ulët me çmime manipulative për të rrëzuar konkurrencën e lirë, konsistojnë në faktet që i kemi siguruar gjatë qasjes zyrtare në dosjen e tij dhe të cilat janë:

Nuk e ka plotësuar kërkesën nga neni 9.2 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së lidhur me kapacitetin teknik – mjetet e punës për shkak se: dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) në tërësi janë të palexueshme, nuk iu dihet përmbajtja e tyre dhe si të tilla ato nuk kanë ndonjë fuqi provuese/dëshmuese, janë ekuivalente me një dokument si letër e bardhë. Nga këto dokumente nuk dihet përshkrimi se për qfarë pajisjes bëhet fjalë, nuk dihet se kush është pronari i pajisjes, nuk dihet validiteti i regjistrimit, etj. Pra vet ky fakt tregon se AK nuk e ka bërë vlerësimin mbi bazën e gjendjes faktike dhe mbështeten ligjore nga neni 59 i LPP-se por mbi bazën e qëllimit për ta favorizuar OE në fjalë duke e vlerësuar si tender të përgjegjshëm mbi bazën e letrave të bardha ku nuk dihet se çfarë pajisje i njëjti ka ofruar për ta plotësuar kapacitetin teknik të kërkuar në nenin 9.2&9.1 të FTD-së së dosjes së tenderit. Këto dëshmi ia prezantojmë panelit shqyrtues dhe përfaqësuesit te AK-së të cilin edhe e pyesim para panelit se me këto dëshmi ku nuk shihet asgjë se çfarë përmbajtjesh kanë, ligjërisht a mund të plotësohet kërkesa nga neni 9.2&9.1 e dosjes së tenderit.

Dhe për më tepër të njëjtat pajisje që i ka huazuar me marrëveshje nga OE "Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE "Bejta Comerce".

Ka dorëzuar tender jo-normalisht të ulët me çmime manipuluese që nuk përkojnë me çmimet reale të tregut (minimumin e tavanit të tyre) për pjesët relevante të tenderit dhe të cilat plotësojnë të tërësi kushtet ligjore për refuzim të tenderit jo-normalisht të ulët, për pozicionet si në vijim:

- Te pozicioni 3.10 Furnizimi,transporti dhe vendosja e thasëve me rërë (Secutex Soft Rock R601) ose të ngjashme për stabilizimin e skarpateve, sipas detalit të projektit, ka ofruar çmim manipulativ në vlerë prej 5 euro për m^3 që bie në kundërshtim me pozicionet 2.6,2.7 , 4.3, 4.4 dhe 4.8, ku për këto pozicione ka ofruar çmim prej 14 euro për m^3. Nga një analizë e logjikshme krahasuese nxirret në pah fakti se OE në fjalë me çmime manipuluese ka vënë në lajthim Autoritetin AK, për faktin se OE fitues " Arbor Group" SHPK "Teuta-M " SHPK nga Koretini Kamenicë, për një m3 zhavor të cilën e sjellë me kamion ofron një çmim prej 14 euro , ndërsa për 1 m3 zhavor të cilën duhet ta vendos në thasë e cila kapë kosto shumë më të lartë ofron një çmim prej 5 euro.
- Pozicioni 4.7 Furnizimi me material dhe montimi i places nga llamarina e galvanizuar me trashësi te fletës prej 4 mm, ndërsa gjerësia e saj duhet te jete min. 50 cm (1000x500x4) ,e mbështetur ne

shtyllat e vendosura ne te dyja anët si mbështetje e drejtimit te shtegut Për këtë pozicion për 1kg ka ofruar një çmim prej 0.40 cent, që i bie se me këtë çmim nuk mund që të bëj vetëm shërbimin e montimit e në asnjë mënyrë furnizimin e saj, dhe ky çmim bie në kundërshtim edhe me

- pozicionin 4.6 Furnizimi me material demontimi i shtyllave te çelikut te galvanizuar me dimensione 50x50x4mm, ne pozicionet e përcaktuara sipas projektit. Shtyllat duhet te jene te ngulitura ne bazamentin prej guri te thyer te nevojshme për mbështetjen e llamarinës kufizuese te shtegut, ku për këtë pozicion ka ofruar çmimin 1.10 euro,pasi që dy pozicionet janë me material të njëjtë.

Siç ju kemi njoftuar në përgjigjen lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, eksperti në ekspertizë nuk e ka trajtuar fare pozicionin nr. 3.10 i cili në arsyetimin ligjor sipas nenit 61 të LPP-së dhe Rregullores për tender jo-normalisht të ulët dhe arsyetimin faktik përbën tender-jo normalisht të ulët. Andaj kërkojmë nga paneli shqyrtues qe i njëjti te shqyrtohet duke përdorur formulën për çmime jo-normalisht te ulëta".
Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Mustafa i cili deklaroj: "Ne qëndrojmë pran vendimit tone, për Autoriteti Kontraktues ndërsa sa i përket pretendimeve te OE ELbau Nuk i ka sjelle ateste qe i posedon pllakat terraco dhe ISO-n, Gjithë ashtu tek licenca e Ministrisë se bujqësisë piper prodhim dhe tregtim te bimëve dekorative ka sjell me marrëveshje nuk është ne konsorcium kjo ka qenë kriter, si dhe pretendimet se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kushtet ne besojmë qe i plotëson, si dhe El-Bau ka qen ne qasje vet e ka pohuar se ka problem personal me këtë OE te rekomanduar. Komisioni ka shqyrtuar dhe OE i rekomanduar i posedon librezat. I rekomanduari i plotëson te gjitha kushtet për kontrate".

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese znj. Beka deklaroj: "Unë kam dhenë përgjigje ne pretendime sa i përket OE "Elbau" disa janë te bazuara, ne një pozicion ka çmim anormal te ulet i rekomanduari për kontrate edhe pse ne një pozicion është bërë një gabim ne përgatitjen e ankese pozicioni 3.1 është dashtë te jetë pozicion 3.10 ndërsa unë se kam llogarite. Qëndroj prapa raportit te dhënë ne ekspertize".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese deklaroj: "Kërkojmë qe ankesa jone te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese deklaroj: "Andaj duke u bazuar ne argumentet dhe provat e paraqitura ne ankese ne qëndrojmë ne tërësi pranë te gjitha pretendimeve ankimore, dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se qe te caktoje seance për shqyrtim kryesor dhe pas shqyrtimit dhe administrimit te provave për secilin pretendim veç e veç, deklarimit te palëve, te marre vendim ne atë mënyrë qe te PRANOHET e bazuar ankesa e ankuesit OE EL-BAU.

Po ashtu te ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE "Arbor Group» sh.p.k. & K.N.T.SH «Teuta-M" sh.p.k. i dt. 06.06.2019, ANULOHET Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE "El-Bau.", i dt. 06.06.2019 dhe te URDHEROHET AK qe lenden ta ktheje ne RI-VLERESIM duke marrë masa korrigjuese për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Ne kërkojmë qe te vërtetohet njoftimi mbi vendim dhe te hedhen poshtë ankesat e OE-ve ankuese si te pabazuara"

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, deklarimeve në seancën për shqyrtim kryesor, raportit të ekspertit shqyrtues profesional, konstatoj se pretendimi ankimor i OE se parë ankues "Nika Pro ing & Bejta Comerc" sh. ase janë eliminuar se nuk kanë plotësuar kërkesat sipas FTD-së, është pjesërisht i qëndrueshëm pasi që OE ankues ka pasur te drejtë të kërkoj sqarim nga AK në lidhje me paqartësitë në dosje të tenderit duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt.18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kërkesës tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare që OE ankues të sjellë në këtë fazë certifikatën EN-13748-2 & ISO 9001:2015, paneli shqyrtues sqaron se në ofertë ne OE ankues "Nika Pro-ing & Bejt Commerc" është e bashkangjitur një deklaratë ku është cekur se do të ofroni pllaka tarraco me EC dhe të certifikuara me ISO standarde të kërkuar, Kërkesa dhe dëshmia e AK-se për këtë pike ka qene qe **OE duhet te siguroj AK-ne**, pra AK nuk e ka potencuar qarte kështu qe OE ankues e ka dorëzuar një deklarate, Andaj në këtë pikë pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i OE ankues se janë eliminuar për arsye se i mungojnë dy kamioneta-min 2 copa & pompa e ujit 2 copa dhe se ne listën e makinerisë te "Bejta Commerc" janë të dëshmuara edhe nga ana e noterit EN minutes se këto makineri edhe tjerat e më shumë janë të dëshmuara se janë në pronësi te OE "Bejta Commerc "nga Gjilani, paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK –së dhe dokumentacionit të bashkangjitur në ofertë konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë:Lista e pajisjeve e vërtetuar nga operatori ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes. Listës së pajisjeve t'i bashkëngjiten këto dëshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes. Makineria e cila merret në huazim, ti bashkëngjitet edhe marrëveshjen e bashkëpunimit-huazimit-qiramarrjes (të noterizuar). Paneli shqyrtues sqaron se ne dokumentacionin e bashkangjitur ne ofertën e Grupi i OE "Nika Pro-ing dhe Bejta Comerce" lista e pajisjeve e vërtetuar nga Operatori Ekonomik dhe e noterizuar me procedure EN minutes është e bashkangjitur në ofertë, në këtë listë figurojnë 2 kamion cisterne, ndërsa sa i përket kamionetave në ankesën e bërë nuk është sqaruar se çfarë gabimi teknik është bere tek shënimi i

kamionëve, andaj këtë pretendim paneli shqyrtues e vlerëson si pjesërisht të bazuar, AK nëse ka dilema lidhur me këtë pretendim gjate rivlerësimit mund te kërkoj informata dhe sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së.

Pretendimin ankimor të OE ankues në lidhje me listën e stafit me saktësisht inxhinierin z. Bashkim Hasani paneli shqyrtues e konsideron si te bazuar dhe konstaton se i njëjti plotëson kërkesën e AK-së dhe kjo pikë ankimore është vërtetuar edhe nga AK-ja në përgjigjeje e kërkesës për ri-shqyrtim .

Pretendimi ankimor i OE ankues "Nika Pro ing dhe Bejta" se AK-ja në kundërshtim më LPP-në ka vepruar kur ka konstatuar i mungojnë licenca nga Ministria e Bujqësisë për prodhim, tregtim dhe import të bimëve dekorative, pasi qe marrëveshja e bashkëpunimit me z Naim Maliqin nuk vlen për plotësimin e kërkesës së AK-së dhe se të njëjtit e kanë plotësuar këtë kriter pasi që në marrëveshjen e noterizuar kanë cekur se furnizimet i bën kompania e licencuar, paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë: Dëshmi- Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim, tregtim dhe import te bimëve dekorative (kopje e noterizuar), prandaj marrëveshja e ofruar nga OE ankues nuk mund të konsiderohet e vlefshme pasi që nuk ka qenë kërkesë e AK-së qe të plotësohet me ndonjë marrëveshje bashkëpunimi, andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar por AK duhet ti trajtoj te gjithë OE-te ofertues konform nenit 7, pasi qe për OE te rekomanduar për kontrate, për kërkesa te njëjta i pranon marrëveshjet.

Në lidhje me pretendimin ankimor për Licencat nga Ministria e Bujqësisë për Prodhim që sipas OE ankues AK-ja këtë kriter e ka vendosur në kundërshtim më LPP-në pasi qe në paramasën e këtij projekti nuk është për të mbjellur asnjë bimë, apo drunj dekorativ, paneli shqyrtues e konstaton se ky pretendim është i paqëndrueshëm pasiqë OE duke u bazuar ne nenin 108/A paragrafi 1 dhe 3.1 të LPP-së OE ankues ka pasur te drejtë të paraqes kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së ne këto raste deri ne afatin kohor te përcaktuar me neni 108/A: [*Ç'do palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

1.3. Në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave].

Pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasi nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme 750.000,00 ku në raste konzerciumi lideri duhet të ketë 60% të vlerës së kontratës, paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e AK –së në këtë pikë në dosjen e tenderit ka qenë: "Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin për kontrate ka kryer me sukses pune të natyrës së ngjashme. Vlera e punëve te kryera duhet te jete minimumi 750,000.00 euro", andaj duke u bazuar ne kërkesat e AK-së paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron pasi qe tek ky kriter nuk është kërkuar që në raste konzerciumi lideri duhet të këtë 60% të vlerës së kërkuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE të dytë ankues "EL-Bau "sh.p.k - Gjilan se AK ne nenin 9.2 nuk është kërkuar asnjë dëshmi dokumentare duke përfshirë por pa u kufizuar ne Marrëveshje me prodhuesin, Licencë për prodhimet e betonit-pllakave tarraco me CE, por që shprehimisht është përshkruar kërkesa si në pikën 9.1 dhe se kërkesa e AK-së është qe materiali/produkti në fjalë duhet të posedojë teste të certifikuara me shenjen CE nga prodhuesi i cili duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (sistemi për menaxhimin e cilësisë", paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar pasiqëOE ankues e plotëson në tërësi kërkesën në fjalë ngase i ka në posedim certifikatat specifike të kërkuara nga AK dhe se kërkesat e AK – së nuk ka qenë të qarta ku kërkesat e vendosura ne DT tek kapaciteti teknik dhe profesional janë të njëjta me dëshmitë e kërkuara dokumentare. Paneli shqyrtues vlerëson se sa i përket kësaj pike OE ankues ka pasur te drejtë të kërkoj sqarim nga AK-ës duke u bazuar tek pika 16.1 e FTD- Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me dt.18.04.2019. Ndërsa sa i përket plotësimit të kësaj kërkese paneli sqaron se në ofertën e OE ankues "El Bau' është e bashkangjitur një deklaratë ku është cekur se do të ofrojnë ateste sipas kërkesës se AK-së për pozicionet të cilat janë ne paramasë. nuk ka qenë kërkesë e AK-së qe të plotësohet me ndonjë marrëveshje bashkëpunimi, andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar por AK duhet ti trajtoj te gjithë OE-te ofertues konform nenit 7, pasi qe për OE te rekomanduar për kontrate, për kërkesa te njëjta i pranon marrëveshjet.

Pretendimi tjeter i OE ankues "EL-Bau "sh.p.k – Gjilan, është se AK *tek kapaciteti teknik dhe profesional- pajisjet makinerike mungojnë libreza dhe DUD nuk i ka të dëshmuara siç është kërkuar,* paneli shqyrtues konstaton ne ofertën e OE ankues është e bashkangjitur lista e makinerisë dhe AK-ja është dashur të cek qartë se për cilat makineri mungojnë dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit andaj paneli shqyrtues këtë pretendim ankimor të OE ankues e vlerëson si të qëndrueshëm.

Pretendimi tjeter i OE ankues "EL-Bau "sh.p.k – Gjilan, se AK ka kufizuar OE kur ata e konsiderojnë të nevojshme që me OE të caktuar që posedojnë kapacitetin e nevojshëm dhe janë të licencuar siç është rasti

konkret për tenderin në fjalë për një pozicion të caktuar për plotësimin e kërkesës lidhur me licencën në fjalë, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, të krijojnë konzerciumi bashkëpunimi,të nënkontraktojnë punën deri në 40% të vlerës së kontratës duke mos lejuar marrëveshje bashkëpunimi është i paqëndrueshëm sepse sipas nenit 108/A të LPP-së paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thotë:

4. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   1.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Prandaj OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim/ ankesë pranë AK-ës dhe OSHP-së në kritere brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave. Dhe si i tillë ky pretendim në këtë fazë të këtij aktivitetit të prokurimit nuk qëndron.

Pretendimi tjeter i OE ankues "EL-Bau "sh.p.k – Gjilan, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën nga neni 9.2 të FTD-së lidhur më kapacitetin teknik mjetet e punës për shkak se dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) në tërësi janë të palexueshme, nuk iu dihet përmbajtja dhe si të tilla nuk kanë ndonjë fuqi provuese /dëshmuese, janë ekuivalente me një dokument si letër e bardhë dhe për me tepër të njëjtat pajisje qe i ka huazuar me marrëveshje nga OE "Bejta Comerce" janë përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce", paneli shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se ne ofertën e OE "Arbor sh.p.k për listën e pajisjeve dëshmitë të cilat i ka ofruar (librezat e qarkullimit dhe DUD-at) disa nga to janë te palexueshme po ashtu disa makineri të cilat i ka huazuar me marrëveshje nga OE Bejta comerce" janë të njëjta që do ti përdorur në këtë aktivitet edhe nga vet tenderuesi OE " Bejta Commerce", prandaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues "EL-Bau "sh.p.k – Gjilan, se OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmime ab-normalisht të ulët ne pozicionet 3.1, 4.6 dhe 4.7, paneli shqyrtues duke u bazuar ne rregullat për tenderin ab-normalisht të ulët dhe në llogaritjet për pozicion paneli shqyrtues konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 3.1 nuk mund te konsiderohet si pozicion ab-normalisht e ulet, andaj pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne rregullat për tenderin ab-normal të ulët dhe në llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 6.4 nuk mund te konsiderohet si oferte ab-normalisht e ulet pasi qe nuk ka përmbushur tri kushtet

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne llogaritjet për pozicion konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë tek pozicioni 4.7 konsiderohet si pozicion ab-normal e ulët. Po ashtu paneli shqyrtues sqaron se AK duke u bazuar ne rregulloren për çmimin ab-normalisht të ulet është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime në lidhje me këtë pozicion andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues për dyshimin për vendosjen e kritereve favorizuese për OE fitues dhe diskriminuese për OE tjerë dhe në kundërshtim me objektin e lëndës nga AK paneli shqyrtues sa i përket këtij pretendimi duke u bazuar ne nenin 108/A të LPP-së konstaton se paragrafi 1 dhe 1.3 i këtij neni thotë:

5. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

   1.4 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Prandaj OE ankues sa i përket kësaj pike është dashur të paraqes kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së në kritere brenda pesë ditëve para afatit për dorëzim te ofertave dhe si të tillë këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues e vlerëson si të paqëndrueshëm.

Pretendimin ankimor të OE ankues se AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqyrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar pasiqë sipas nenit 108/A te LPP-në paragrafi 12:

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

Andaj AK është dashur te jap përgjigje në te gjitha pretendimet ankimore te OE ankues dhe ti arsyetoj ato.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 7, nenit 59 dhe njëkohësisht nuk është respektuar neni 60i LPP-së, ku kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët si dhe dispozitat tjera te LPP-së.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë te obliguara ti respektojnë te gjitha dispozitat e LPP-se gjithashtu te kenë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Po ashtu autoritetet kontraktuese janë te obliguara për te vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –MMPH

1x1 OE-ve ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.